



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 4408 Prot

Maliq, më 20.8.2023

LËNDA: Shpallje publike.

NJËSISË ADMINISTRATIVE 570718

THIRRJE PËR APLIKIM MBI PROGRAMET E STREHIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018”, “Për strehimin social” i ndryshuar me ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018”, “Për strehimin social”, VKM nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, njoftojmë të gjithë të pa strehët e bashkisë Maliq se përfshirja në programet sociale të strehimit (nga momenti i daljes së këtij njoftimi) do të bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës on-line në portalin unik qeveritar “e-Albania”. Të gjithë aplikantët e vjetër apo të rinj, janë të lutur të plotësojnë formularin “Kërkesë për të përfutuar nga programet e strehimit social” në portalin “e-Albania” ose të paraqiten pranë bashkisë Maliq për të marrë të gjithë informacionin dhe asistencën e nevojshme mbi mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Kujtesë:

- Aplikimet për programin “Banesë Sociale me qira” ose në mungesë të BSQ “Subvencioni i qirasë”, për vitin buxhetor 2024 do të jenë të hapura deri më datë 30.11.2023 (përfshirë rastet emergjente).
- Aplikimet për programin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për kategori të varfëra dhe të pa favorizuara”, për vitin buxhetor 2024 do të jenë të hapura deri më datë 31.10.2023 (përfshirë rastet emergjente).
- Aplikimet për programin “Subvencioni i Interesave të Kredisë” ndryshe (kredi e butë) do janë të hapura në çdo kohë deri në plotësimin e kuotave të përcaktuara nga MFE.

Për çdo informacion mbi mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar, lutemi të paraqiteni pranë zyrës së strehimit bashkia Maliq nga e Hëna në të Premte ora:08.ºº-13.ºº ose klikoni në Website-n <https://www.bashkiamaliq.gov.al>.

Faleminderit për mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETARI I BASHKISË
Eridjon Rustemi

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

Tel. & Fax: 086122026

www.bashkiamaliq.gov.al



Nr: 114
Datë: 22.08.2023
[Signature]